

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIME PËR REALIZIMIN E EVENTEVE PËR AGJENCINË E INOVACIONIT DHE EKSELENCËS”, e ndarë në 2 (Dy) Lote:

- **Loti 1:** “Shërbime për realizimin e eventit: “Flakadani i Bashkimit për Inovacionin në Shqipëri”;
- **Loti 2:** “Shërbime për realizimin e eventit: “Gjenerata e Inovacionit”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 79952000-2;

VLERA E FONDIT LIMIT: 13,953,592 (trembëdhjetë milion e nëntë qind e pesëdhjetë e tre mijë e pesë qind e nëntëdhjetë e dy) **Lekë pa TVSH**, e ndarë në 2 (dy) lote si më poshtë:

- **LOTI 1** “Shërbime për realizimin e eventit: “Flakadani i Bashkimit për Inovacionin në Shqipëri”, me fond limit: **11,309,192** (njëmbëdhjetë milion e treqind e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e dy) **Lekë pa TVSH;**
- **LOTI 2** “Shërbime për realizimin e eventit: “Gjenerata e Inovacionit”, me fond limit: **2,644,400** (dy milion e gjashtëqind e dyzet e katërmijë e katërqind) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Loti 1: “Shërbime për realizimin e eventit: “Flakadani i Bashkimit për Inovacionin në Shqipëri”;

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomikë kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjës Fotograf
- b) 1 (një) punonjës Videograf
- c) 2 (dy) punonjës Teknik Audio
- d) 1 (një) punonjës grafik- dizajner
- e) 2 (dy) punonjës Teknikë Ndriçimi
- f) 1 (një) punonjës Teknikë Regjie
- g) 1 (një) punonjës Skenograf
- h) 1 (një) punonjës Skenarist
- i) 1 (një) punonjës Zhvillues webi/programues ose ekuivalent
- j) 1 (një) punonjës DJ
- k) 1 (një) punonjës Menaxher Event

Për punonjësin më sipër duhet të paraqitet :

- kontratë pune ose kontratë shërbimi/angazhimi apo çdo marrëveshje tjetër kontraktuale, të vlefshme gjatë afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër, për secilin profil;

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike dhe shërbimeve që duhet të realizojë ofertuesi, hartuar nga AK, me qëllim sigurimin e AK se shërbimi i realizimit të eventeve, objekt prokurimi do të realizohet nga punonjës të kualifikuar për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Fotografi është përgjegjës për fotografimin profesional të momenteve të rëndësishme, gjatë eventit duke përfshirë momentet kryesore, interaksionet e pjesëmarrësve, dhe atmosferën e përgjithshme. Fotografi është përgjegjës për realizimin e fotografimit, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.

Videografi është përgjegjës për xhirimin profesional gjatë eventit, duke përdorur pajisje të avancuar dhe përmbushur të gjitha kërkesat e AK, të përcaktuara në specifikimet teknike.

Teknik Audio është përgjegjës për mbarëvajtjen e pajisjeve teknike, si mikrofonta, miksues, spekë, etj, të përcaktuar në specifikime teknike. Teknik Ndriçimi është përgjegjës për mbarëvajtjen e pajisjeve teknike, si drita led, kontroller, efekte etj. të përcaktuar në specifikime teknike.

Grafik dizanjer është përgjegjës për krijimin e elementëve vizualë, për konceptin e diznjat grafik në elementët përbërës të objektit të prokurimit, si skenografi, foltore e branduar, brandbook, tottebags e materiale të tjera, integrimin e grafikëve në materialet e rregjistruara, etj., duke siguruar që identiteti vizual të jetë në përmbushje të standarteve dhe kërkesave të AK.

Teknikë Regjie është përgjegjës për përdorimin e pajisjeve teknike të avancuara, si dhe programe për menaxhimin e drejtëpërdrejtë, së bashku me një sistem komunikimi gjithëpërfshirës për koordinimin efikas të eventit.

Teknik skenografie është përgjegjës për dizanjimin e hapësirës teknike, të përshtatur me eventin dhe në përmbushje të kërkesave të AK.

Zhvillues webi/programues ose ekuivalent është i nevojshëm për përmbushjen e specifikimeve teknike si zhvillimin e aplikacionit për menaxhim eventit, shërbimit e transkriptimit live, spotet promovuese, optimizimin e SEO/Google, etj.

DJ është i nevojshëm për realizimin e shërbimit të DJ, sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të AK.

Menaxher Eventit ka një rol të rëndësishëm në kryerjen dhe realizimin e shërbimit, objekt prokurimi në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara. Përgjegjësi i shërbimit planifikon dhe ndjek zbatimin e çdo faze të objektit të prokurimit, koordinon punën me punonjësit e tjerë të përfshirë, dhe siguron që të gjitha aktivitetet të përputhen me objektivat e AK.

Menaxheri Eventi ndihmon në zgjedhjen dhe menaxhimin efektiv të sallave, duke marrë në konsideratë numrin e pjesëmarrësve, kërkesat specifike të eventit dhe shërbimet e tjera ndihmëse, koordinon të gjitha detajet teknike dhe operacionale, menaxhon situatat që mund të ndodhin duke minimizuar ndikimin e tyre në event.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objektin e prokurimit dhe proceset e punës, të cilat duhet të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve përkatësisht:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
- ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqiten:

Çertifikatat përkatëse, objekti i së cilave duhet të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jenë brenda afatit të vlefshmërisë të paktën në datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standard fokusohet në cilësinë e realizimit të eventeve, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti garanton AK se ofertuesi do të realizojë të gjithë elementët e eventit (skenografia, dekorim, ndriçim, catering/refreshment/lunch boxes, regji, etj.) me standarte cilësore, si dhe garanton AK në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve.

Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku, pasi shërbimet që do të kryhen përfshijnë një sërë rreziqesh për aksidente në punë, si dëmtime nga pajisjet, rrëshqitjet, rënia e pajisjeve teknike, elektriciteti, etj..

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojnë se:

- Marrin përsipër transportimin, montimin, mbarëvajtjen teknike, çmontimin dhe largimin e paisjeve pas përfundimit të çdo aktiviteti, të gjitha pajisjet teknike të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit në vendin përkatës, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Disponojnë pajisjet teknike për realizimin e objektit të prokurimit, sipas specifikimeve teknike.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke analizuar elementët përbërës të objektit të prokurimit, me anë të deklaratave të sipërcituara, AK krijon siguri se ofertuesi do të marrë përsipër realizimin e eventit (duke përfshirë

transportimin, montimin, çmontim, mbarëvajtje teknike, etj. të pajisjeve teknike dhe disponimin e tyre, pa kosto shtesë nga oferta fillestare.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Loti 2: “Shërbime për realizimin e eventit: “Gjenerata e Inovacionit”;

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektivit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës Fotograf
- 1(një) punonjës Videograf
- 1 (një) punonjës Teknik Audio
- 1 (një) punonjës grafik- dizajner
- 1 (një) punonjës Teknikë Ndriçimi
- 1 (një) punonjës Zhvillues webi/programues ose ekuivalent
- 1 (një) punonjës DJ
- 1 (një) punonjës Menaxher Eventi

Për punonjësin më sipër duhet të paraqitet :

- kontratë pune ose kontratë shërbimi/angazhimi apo çdo marrëveshje tjetër kontraktuale, të vlefshme gjatë afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër, për secilin profil;

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike dhe shërbimeve që duhet të realizojë ofertuesi, hartuar nga AK, me qëllim sigurimin e AK se shërbimi i realizimit të eventeve, objekt prokurimi do të realizohet nga punonjës të kualifikuar për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Fotografi është përgjegjës për fotografimin profesional të momenteve të rëndësishme, gjatë eventit duke përfshirë momentet kryesore, interaksionet e pjesëmarrësve, dhe atmosferën e përgjithshme. Fotografi është përgjegjës për realizimin e fotografimit, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.

Videografi është përgjegjës për xhirimin profesional gjatë eventit, duke përdorur pajisje të avancuar dhe përmbushur të gjitha kërkesat e AK, të përcaktuara në specifikimet teknike.

Teknik Audio është përgjegjës për mbarëvajtjen e pajisjeve teknike, si mikrofona, miksues, spekë, etj, të përcaktuar në specifikime teknike. Teknik Ndriçimi është përgjegjës për mbarëvajtjen e pajisjeve teknike, si drita led, kontroller, efekte etj. të përcaktuar në specifikime teknike.

Grafik dizajner është përgjegjës për krijimin e elementëve vizualë, për konceptin e diznjat grafik në elementët përbërës të objektit të prokurimit, si skenografi, foltore e branduar, brandbook, tottebags e materiale të tjera, integrimin e grafikëve në materialet e rregjistruara, etj., duke siguruar që identiteti vizual të jetë në përmbushje të standarteve dhe kërkesave të AK.

Zhvillues webi/programues ose ekuivalent është i nevojshëm për përmbushjen e specifikimeve teknike si zhvillimin e aplikacionit për menaxhim eventit, shërbimit e transkriptimit live, spotet promovuese, optimizimin e SEO/Google, etj.

DJ është i nevojshëm për realizimin e shërbimit të DJ, sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të AK.

Menaxheri ka një rol të rëndësishëm në kryerjen dhe realizimin e shërbimit, objekt prokurimi në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara. Përgjegjësi i shërbimit planifikon dhe ndjek zbatimin e çdo faze të objektit të prokurimit, koordinon punën me punonjësit e tjerë të përfshirë, dhe siguron që të gjitha aktivitetet të përputhen me objektivat e AK.

Menaxheri ndihmon në zgjedhjen dhe menaxhimin efektiv të sallave, duke marrë në konsideratë numrin e pjesëmarrësve, kërkesat specifike të eventit dhe shërbimet e tjera ndihmëse, koordinon të gjitha detajet teknike dhe operacionale, menaxhon situatat që mund të ndodhin duke minimizuar ndikimin e tyre në event.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës, të cilat duhet të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve përkatësisht:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
- ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqiten:

Çertifikatat përkatëse, objektivi i së cilave duhet të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jenë brenda afatit të vlefshmërisë të paktën në datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standard fokusohet në cilësinë e realizimit të eventeve, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti garanton AK se ofertuesi do të realizojë të gjithë elementët e eventit (skenografia, dekorim, ndriçim, catering/refreshment/lunch boxes, regji, etj.) me standarte cilësore, si dhe garanton AK në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve.

Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku, pasi shërbimet që do të kryhen përfshijnë një sërë rreziqesh për aksidente në punë, si dëmtime nga pajisjet, rrëshqitjet, rënia e pajisjeve teknike, etj..

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të dekaltojnë se:

- Marrin përsipër transportimin, montimin, mbarëvajtjen teknike, çmontimin dhe largimin e paisjeve pas përfundimit të çdo aktiviteti, të gjitha pajisjet teknike të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit në vendin përkatës, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Disponojnë pajisjet teknike për realizimin e objektit të prokurimit, sipas specifikimeve teknike.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke analizuar elementët përbërës të objektit të prokurimit, me anë të deklaratave të sipërcituara, AK krijon siguri se ofertuesi do të marrë përsipër realizimin e eventit (duke përfshirë transportimin, montimin, çmontim, mbarëvajtje teknike, etj. të pajisjeve teknike dhe disponimin e tyre, pa kosto shtesë nga oferta fillestare.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT